



Me dt. 29.05.2013 në sheshin “Nënë Tereza“ në ora 11: 55, BSPK organizon:

PROTESTË

me moton : *“pesë minuta para dymbëdhjetëve”*,

Ju njoftojmë se BSPK së bashku me degët e saja Sindikale me zyrat regjionale të saj me Sindikatën e Pensionistëve të Kosovës dhe me OJQ-të të ndryshme organizon protestë me këto kërkesa:

1. Kërkojmë zbatimin e ligjeve në praktikë (për të drejtat e punëtorëve),
2. Kërkojmë nënshkrimin e marrëveshjes kolektive,
3. Kërkojmë zbatimin e marrëveshjes për pagën minimale, prej 220 €.
4. Kërkojmë miratimin e ligjit për pensionistët,
5. Kërkojmë pranimin e stazhit të punës për vitet 1990 - 1999.
6. Kërkojmë krijimin e fondit social për punëtorët, që privatizimi i la papunë.
7. Kërkojmë funksionimin e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme (20 % nga privatizimi i ndërmarrjeve)

Vendtakimi i protestuesve do të jetë parkingu i autobusëve tek Sheshi 21 dhe parakalimi do të bëhet prej udhëkryqit tek Katedrala drejt hotelit Grand dhe pikëtakimi do të jetë para Teatri Kombëtar në Sheshin “Nëna Terezë”

Ftojmë të gjithë anëtarët e sindikatave përkatëse për një pjesëmarrje masive dhe një protestë dinjitoze në mënyrë që kërkesat tona të kenë mbështetjen e denjë.

Kërkesave të lartë cekura mund t'i bashkëngjiten edhe sloganet tjera, varësisht prej specifikave që i kanë shoqatat sindikale nga regjionet e Kosovës, si dhe të gjitha subjektet që e përkrahin këtë protestë.

Prishtinë 22 Maj 2013

Këshilli organizativ i protestës